



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA V

Komisioni për bujqësi, pylltari, mjedis dhe planifikim hapësinor

Mbledhja nr. 25

Prishtinë, më 25.11.2015, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-303

PROCESVERBAL

i mbledhjes së komisionit për bujqësi, pylltari dhe mjedis e planifikim hapësinor

Në mbledhje morën pjesë : Fikrim Damka, Adem Salihaj, Murat Hoxha, Shaip Muja, Srdjan Popović.

Munguan : Lahi Brahimaj, Haxhi Shala, Salih Salihu, Emilija Redzeqi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë sipas listës së nënshkrimeve.

Stafi mbështetës i Komisionit : Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Fikrim Damka**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 17.11.2015,
3. Shqyrtimi i projektligjit për rregullimin e shërbimeve të ujit ,
4. Te ndryshme ;

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës për këtë mbledhje u miratua pa ndryshime dhe u shtua edhe një pikë për të ndryshme : Demarkacioni me Malin e Zi.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 17.11.2015

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i projektligjit për rregullimin e shërbimeve të ujit

Kryesuesi Fikrim Damka njoftoi komisionin për vërejtjet nga komisionet e përhershme për të cilat **Komisioni** vendosi që të mbështeten amendamentet e propozuara të komisionit për buxhet dhe rekomandimet e komisionit për legjislacion, përveç Amendamentit 4 të komisionit funksional e cila para se të procedohet për leximin e dytë duhet të sqarohet në stafin ligjor : komisioni parlamentar a është kompetent për akte nënligjore apo jo. Stafi i komisionit sugjeroi që të fshihet amendamenti, ngase komisioni parlamentar nuk nxjerr përkatësisht nuk merret me akte nënligjore, por komisioni kërkoi sqarim edhe nga stafi i gjërë ligjor i kuvendit.

4. Të ndryshme

Kryesuesi Fikrim Damka hapi diskutimin rreth temës që propozoi **Shaip Muja** për Demarkacionin e Kosovës dhe Malit të zi. Z. Muja theksoi se komisionit ja ka dërguar shkresën lidhur me këtë temë por sqaroi edhe një herë iniciativën e tij për të shqyrtuar këtë demarkacion ky komision ngase është komision funksional për këtë fushë, në fakt ai nuk e ka të qartë si ka ndodhur që kjo çështje të shkoi në Komisionin për marrëdhënie me jashtë ndërsa nuk ka ardhë në këtë komision si kompetencë funksionale. Ai kërkoi që të formohet një nënkomision në kuadër të këtij komisioni për të hartuar qëndrimet politike pasi që Qeveria ka dhënë shenja se kjo marrëveshje mund të rishikohet si në aspektin ndërkombëtarë ashtu edhe kombëtar para se ta marr formën juridike, pasi që komisioni shtetëror qeveritar nuk na ka bindur se bëhet fjalë për kufinj meritore. **Fikrim Damka** dhe **Adem Salihaj** ishin të mendimit se iniciativa e z. Muja nuk është jashtë rregullores mirëpo ajo vjen në shprehje pasi që kjo marrëveshje të arrij në Kuvend, me ç'rast kryesia duhet të përcjellë këtë çështje në këtë komision. **Shaip Muja** sërish insistoi në formimin e nënkomisionit dhe ju drejtua Adem Salihajt se i njëjti është për të blerë kohën, njëherit mediave ju drejtua se shkresa e tij nga sot është publike.

Adem Salihaj : nëse ka shkuar kjo marrëveshje diku tjetër, ne duhet të kërkojmë nga kryesia ta sjellë te ne (në këtë komision), ngase anëtarët e këtij komisioni nuk mund të bisedojnë në grupet parlamentare pa ardhur në kuvend,

Shaip Muja : na vetëm i ndihmojmë Qeverisë nëse kryejmë punën tonë në komision, përndryshe ne kemi hesht dhe nëse nuk veprojmë po hyjmë edhe më tepër në një anarki,

Murat Hoxha : asgjë nuk është tabu, duhet të shqyrtojmë, marrëveshja ka shkua në komisionin e jashtëm ngase ka elemente të jashtme, por duhet të vij edhe në këtë komision, propozoi të pyesim kryesin me marr kompetencën ky komision, përndryshe nga informacionet e publikuara në opinion nuk pajtohem edhe unë me këtë demarkacion,

kryesore është të ecim bashkë, nuk mjafton vetëm Shaipi, Iliri ose Vjosa ose tjetër kush individualisht,

Shaip Muja : Iliri dhe Vjosa janë duke bërë plagjiaturë asgjë tjetër, pse askush nuk del ta kundërshtoi publikisht Shpëtim Bulliqin (ekspertin që publikoi mendimin në opinion), unë po përsëris, ne nuk jemi tue krye detyrën që na takon, lidershipi po udhëheq me deputet individual, kjo është.

Pasi që komisioni mbeti pa kuorum dhe pas sugjerimeve se si të veprohet, **kryesuesi Fikrim Damka** potencoi faktin se në vazhdim do të akordohet me anëtarët e komisionit si të veprohet më tutje me këtë iniciativë.

Mbledhja përfundoi në orën 15,00.

Përgatitur nga stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i Komisionit,
Fikrim Damka